



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ANALIZA VJETORE PËR VITIN 2021



GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
DURRËS

- DURRËS 2022 -



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR DURRËS

ANALIZA E PUNËS SË GJYKATËS SË RRETHIT GJYQËSOR
DURRËS GJATË VITIT 2021

DURRËS 2022



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR Durrës

Nr. ____ Prot

Durrës, më ____ . ____ .2022

ANALIZA E PUNËS SË GJYKATËS SË RRETHIT GJYQËSOR Durrës
GJATË VITIT 2021

HYRJE

Materiali vijues përfaqëson në mënyrë të përmbledhur punën e kryer nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës gjatë vitit kalendarik 2021 dhe problematikat e hasura gjatë këtij viti sa i takon funksionimit të institucionit në tërësi.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, në vitin 2021, në strukturën e saj organike ka pasur të miratuar 57 punonjës, nga këta 17 gjyqtarë dhe 40 punonjës të tjerë, por organika në fakt ka qenë 48 punonjës.

Numri i gjyqtarëve në raport me organikën e miratuar ka qenë me mungesa për arsye të vendit vakant të Kryetarit dhe të tre gjyqtarëve. Përveç këtyre, 2 (dy) gjyqtarë janë në proces rivlerësimi në KPA, 1 (një) gjyqtare është pezulluar me Vendimin e KLGJ Nr. 315, datë 14.09.2020 dhe 1 (një) gjyqtare është me leje lindje.

Gjatë vitit 2021, kanë qenë aktivë në procese gjyqësore 9 (nëntë) gjyqtarë.

Për vitin 2021 nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, për Gjykatën tonë janë miratuar 4 punonjës, konkretisht:

- 1 (një) Specialist i Marrëdhënieve me Publikun dhe me Median
- 1 (një) Sekretar Gjyqësor
- 1 (një) Nëpunës Gjyqësor (salla gjykimi)
- 1 (një) Arkivist

Për reflektimin e treguesve të punës, në këtë analizë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës për vitin 2021, është menduar të trajtohen treguesit që lidhen me performancën në menaxhim dhe në vendimmarrje, si dhe tregues që lidhen me tendencën e punës së gjykatës gjatë këtij viti.

Në funksion të një analize trajtuese dhe krahasuese me vitet e mëparshme, treguesit e punës janë evidentuar për çdo gjyqtar më vete dhe për Gjykatën në tërësi si trupë gjyqësore.

Gjithashtu, këtu do të bëhet krahasimi i ngarkesës së kësaj gjykate duke e krahasuar dhe me vitet e mëparshme. Në këtë përmbledhje do të prezantohet dhe ngarkesa, shpejtësia dhe cilësia në aspektin e ecurisë së vendimeve në gjykatat më të larta për secilin gjyqtar.

Në këtë analizë do të mund të vlerësohet dhe trendi i ngarkesës dhe llojit të çështjeve në këtë gjykatë, pra cilat lloje të çështjeve janë rritur më shumë në vitin e fundit si dhe problematika të ndryshme që shtrohen për zgjidhje.

Po kështu, në material janë trajtuar shkurtimisht edhe aspekte që lidhen me infrastrukturën, teknologjinë dhe shërbimet administrative të ofruara nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, elementë këta që gjithashtu vlerësohen të kenë ndikim në performancën e gjykatës.

I. Infrastruktura.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës aktualisht vazhdon të jetë e vendosur në tre katet e para të godinës ekzistuese, e cila rezulton të jetë ndërtuar në vitin 1961, që është përshtatur për të kryer funksionin e Gjykatës.

Në vitin 1988 është ndërtuar kati i katërt i godinës e më pas, pas viteve 1990 është ndërtuar kati i pestë i saj, 2 kate këto në të cilat është vendosur Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës.

Rikonstruksioni i vetëm i godinës është kryer në vitin 1998 nga projekti PHARE dhe nga kjo datë çdo investim ka qenë për mirëmbajtjen e godinës, por në asnjë rast për rikonstruksion të saj.

Aktualisht gjendja e godinës përveç pamjaftueshmërisë së saj, paraqitet tejet e amortizuar dhe tërësisht e papërshtatshme për ushtrimin e detyrës nga ana e gjyqtarëve dhe administratës, si dhe për garantimin e transparencës, trajtimit dinjitoz e solemn të qytetarëve në kërkesat e tyre apo seancat gjyqësore.

Ambientet (*veçanërisht ato të katit të parë*) kanë lagështirë dhe muret janë të dëmtuara si në ambientet e jashtme, ashtu edhe në ato të brendshme të gjykatës.

Veç sa më sipër, godina ekzistuese paraqet problematikë edhe përsa i përket pozicionimit, hapësirave dhe planimetrisë së saj, të cilat bëjnë që kjo Gjykatë të jetë tërësisht e papërshtatshme për ushtrimin e veprimtarisë së saj. Shtuar këtu edhe dëmtimet pjesore të shkaktuara nga tërmeti i Nëntorit 2019.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës ka vetëm 4 salla gjykimi: nga një sallë në katin e parë dhe të dytë dhe dy salla në katin e tretë. Një nga këto salla përdoret ekskluzivisht vetëm për gjykime penale me të pandehur në gjendje arresti, për shkak të mungesës së sigurisë në sallat e tjera, ndërsa tre sallat e tjera përdoren nga të gjithë gjyqtarët sipas planifikimeve të kryera nëpërmjet kalendarit elektronik.

Pavarësisht se përdorimi i sallave të gjykimit rezulton të jetë maksimal, në shumicën e rasteve nga ora 08:30-16:00, është lehtësisht e kuptueshme që numri i sallave të gjykimit në raport me numrin e gjyqtarëve është jashtë çdo standardi dhe nuk plotëson as 50% të ngarkesës së çështjeve që gjykohen në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës. Për këtë shkak ende numri më i madh i gjykimeve zhvillohen në zyrat e gjyqtarëve.

Gjithashtu, duhet theksuar se edhe sallat aktuale të gjykimit nga madhësia, pikëpamja teknike dhe pozicionimi i tyre nuk ofrojnë as zhvillimin në kushte normale të gjykimit dhe as nuk garantojnë sigurinë e gjyqtarëve.

Në mbrojtjen e punës së pavarur të gjyqtarit, një rol të rëndësishëm janë dhe godina e ambientet, zyrat, roja i sigurisë në hyrjet në gjykatë.

Çështja e sigurisë për gjyqtarët duhet të merret parasysh në mënyrë serioze e të trajtohet nga ana e KLGJ-së. Pasiguria në rritje e gjyqtarëve ndikon jo vetëm në pavarësinë dhe paanësinë e gjykatave, por gjithashtu dëmton besueshmërinë dhe autoritetin e institucionit gjyqësor në sytë e publikut.

Aktualisht gjendja e sigurisë të Gjykatës Rrethit Gjyqësor Durrës paraqitet tejet e ulët. Godina ekzistuese nuk garanton as nivelet minimale të sigurisë së gjyqtarëve dhe punonjësve të tjerë të administratës gjyqësore. Në hyrje të Gjykatës është vendosur derë detektimi.

Në godinën e gjykatës jemi përpjekur që të këtë dy hyrjet e saj, të ndara. Njëra është krijuar për administratën dhe Gjyqtarët të cilët duhet të hyjnë në gjykatë vetëm më kartat e hyrëse dhe hyrja tjetër për publikun ku në vitin 2019 kemi instaluar dhe një derë detektimi. Por pavarësisht dy hyrjeve të ndara për gjyqtarët dhe administratën gjyqësore ashtu dhe për publikun, të gjithë hyjnë në të njëjtin korridor dhe shkallët janë të përbashkëta, si për gjyqtarët, ashtu edhe për qytetarët.

Nga ana tjetër, dy nga sallat e gjykimit nuk kanë as dhomë këshillimi dhe gjyqtarët kur hyjnë dhe dalin në sallë ndodhen në të njëjtin ambient me qytetarët, çka nuk garanton as nivelet minimale të sigurisë të gjyqtarëve.

Parkimi i pasëm i gjykatës ka kapacitet vetëm për 5-6 automjete, çka bën që gjyqtarët dhe administrata të parkojnë në ambiente të jashtme të gjykatës, në të cilat nuk mund të garantohet siguria.

Kështu, si gjatë seancave gjyqësore edhe jashtë tyre gjyqtarët kanë një nivel sigurie më pak se minimal, jashtë standardeve evropiane.

Në lidhje me shërbimin e sigurisë, sipas legjislacionit në fuqi nga Komisariati i Policisë Durrës ofrohet asistencë me një punonjës policie në orarin 08:00-15:00, ndërkohë nga ora 15:00-08:00 të ditës pasardhëse shërbimi i sigurisë ofrohet nga një punonjës i shoqërisë private "Illrian Guard" sh.a, të cilët kanë trajnimin e duhur profesional për të garantuar sigurinë specifike të gjykatës. Për përcaktimin e rregullave, detyrimeve reciproke dhe përgjegjësi, është nënshkruar një Rregullore e Përbashkët e Sigurisë ndërmjet titullarëve të Gjykatës dhe Shoqërisë Private.

Sa i takon shërbimeve të ofruara qytetarëve nga ana jonë janë është përshtatur një sportel ku ofrohen shërbimet e Kryesekretarisë dhe shërbimet e tjera si: tërheqja e vërtetimeve, kopjeve të akteve apo vendimeve gjyqësore, etj. Ndërsa shërbimet e financës kryhen brenda gjykatës për shkak të pamundësisë fizike të ambienteve ku të përshtaten sportele për ofrimin e shërbimeve.

Pavarësisht synimit dhe vullnetit për të përshtatur ambiente normale pune për qytetarët, numri i sporteleve dhe vendosja e tyre janë në një ambient të ngushtë dhe të papërshtatshëm për ofrimin cilësor të shërbimeve të kërkuara.

Si rezultat i problematikave të mësipërme nga ana jonë është kërkuar në vijimësi investimi për ndërtimin e një godine të re, e cila të garantojë jo vetëm sigurinë për gjyqtarët dhe administratën, por të garantojë dhënien e drejtësisë sipas standardeve evropiane, duke qenë e projektuar me numrin e nevojshme të sallave të gjykimit, ambiente të ndara për gjyqtarët dhe qytetarët, ambiente të përshtatshme për ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve, etj., kërkesa këto të cilat i janë përcjellë si Zyrës së Administrimit të Buxhetit Gjyqësor, ashtu edhe Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Rëndësinë e një godine të re e shton dhe fakti i krijimit të Hartës Gjyqësore për vitin 2022, sipas së cilës Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës do të përfshijë dhe Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë dhe Kavajë.

II. Sistemi i menaxhimit të çështjeve gjyqësore dhe regjistrimi AUDIO i seancave gjyqësore.

Siç është parashtruar edhe në analizat vjetore të mëparshme, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, që nga viti 2007 e në vijim ka organizuar punën e saj duke u bazuar në sistemin e integruar të menaxhimit të çështjeve civile e penale CCMIS/ICMIS.

Pavarësisht problematikave të evidentuara në mënyrë të vazhdueshme të këtij sistemi dhe zgjidhjeve të ofruara në vijimësi, vlen të theksohet se gjykatat nuk kanë një dokument të aprovuar të politikave të brendshme, i cili rregullon përdorimin e pajisjeve e sistemeve digjitale, zëvendësimin e tyre, apo që adreson çështje të digjitalizimit. Disa gjykata kanë

disa rregullore të brendshme të përdorimit të pajisjeve digjitale. Megjithatë, këto rregullore nuk janë prezente në të gjitha gjykatat e si pasojë nuk janë të unifikuara e standardizuara në nivel kombëtar.

Po kështu, pavarësisht kërkesave të vazhdueshme dhe arritjes aktuale të funksionimit normal të portalit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës si një nga gjykatat që përdorin sistemin ICMIS (informacioni aksesueshëm në faqen zyrtare(www.gjykata.gov.al), e cila administrohet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, gjatë vitit 2019 janë hasur problematika të cilat mbeten tu mbajtur në konsideratë dhe për tu zgjidhur nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Megjithëse nga ana e administratës së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës është kryer një punë e mirë për informimin dhe sensibilizimin e avokatëve, palëve ndërgjyqëse dhe qytetarëve për marrjen e informacionit mbi shortin dhe planifikimet e seancave gjyqësore nëpërmjet faqes elektronike zyrtare, portali ka rezultuar që shpesh të mos jetë funksional, duke shkaktuar pamundësi të marrjes së informacionit nga ana e qytetarëve.

Në shumicën e rasteve portali ka ndërprerë së ri-freskuari informacionin e dhënë nga gjykata jonë, duke mos shfaqur asnjë të dhënë në lidhje me regjistrimin, skedulet dhe shortin. Gjithashtu, edhe për çështjet e vjetra nuk është i aksesueshëm asnjë informacion.

Po kështu, vijon problematika e konstatuar edhe në vitet e mëparshme që lidhet me pamundësinë e hedhjes së informacionit në mënyrën e duhur, pasi modifikimi i strukturës së faqes Web sipas nevojës dhe azhurnimi i të dhënave në këtë portal është i kufizuar, çka e bën të pa-menaxhueshëm nga IT e gjykatës.

Faqja zyrtare elektronike e gjykatës kryen në mënyrë automatike të gjithë procesin e paraqitjes së të dhënave në portalin gjykata.gov.al. Në portalin e gjykatave në hapësirën e dedikuar Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës shfaqet në mënyrë automatike lista e përditësuar e çështjeve gjyqësore, lista e shortit, kalendari i seancave si dhe çdo informacion tjetër që përbën interes publik.

Në kuadër të përmirësimit të shërbimit dhe masave anti Covid-19 në bashkëpunim me KLGJ është implementuar projekti FEA, i cili është një shërbim elektronik që u vjen në ndihmë qytetarëve që të dërgojnë një aplikim për t'u pajisur me kopje të dokumenteve gjyqësore të tilla si, kopje vendimi viti aktual, kopje vendimi (arkiva), kopje të dosjeve gjyqësore, vërtetim për çështje në proces gjykimi (individ), vërtetim për çështje në proces gjykimi (shoqëri tregtare), vërtetim për ndjekje penale. Formulari i aplikimit, është shtuar tashmë si rubrikë e re, në profilin e çdo gjykate, në portalin www.gjykata.gov.al.

Sa i takon balancimit të ngarkesës së gjyqtarëve të Dhomës Civile mund të përmendet që përgjithësisht sistemi arrin të krijojë barazi ndërmjet seksioneve përkatës ku ata gjykojnë lidhur me numrin total të çështjeve të gjykuara. Gjithsesi, në muajin Qershor 2021, Këshilli

i Gjykatës vendosi bashkimin e dy dhomave në një të vetme, për shkak pakësimit të gjyqtarëve.

Nga ana tjetër, një sukses i arritur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, në saj të projektit JUST ka qenë edhe implementimi i sistemit dixhital audio RDA në 4 sallat e gjykimit të gjykatës tonë qysh në shtator 2012 dhe vazhdon të jetë efektiv dhe tërësisht funksional.

Ndërkohë, regjistrimi i seancave gjyqësore Audio është kthyer tashmë në një shprehje të zakonshme të gjyqtarëve dhe pjesëmarrësve të tjerë në gjykim, duke pasur vlera të rëndësishme sa i takon rritjes së transparencës dhe solemnitetit të gjykimit.

Të gjitha sallat e gjykimit gjatë vitit 2021 me qëllim përmirësimin e punës së sekretarisë janë pajisur me mjetet teknologjike më të fundit, duke respektuar parimin e barazisë së qasjes në të njëjtën teknologji si dhe duke siguruar efikasitet në proceset e punës së sekretarisë gjyqësore.

Sigurinë e të dhënave lidhur me çështjet e regjistruara në sistemin RDA, në serverin e gjykatës, falë USAID e mundëson software i instaluar GFI Backup Software. Ky Software shërben për të bërë backup Incremental regjistrimet Audio nga serveri lokal drejt Serverit qendror tek AKSHI, Tiranë. Për të punuar në mënyrë të rregullt sistemi monitorohet dhe për mirëmbahet nga stafi IT (specialistëve të IT).

Bazuar në zhvillimet e fundit lidhur me sistemin Audio, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës ka marrë të gjitha masat e nevojshme për të përmirësuar shërbimin e Internetit, duke rritur shpejtësinë "Upload", në mënyrë që transferimi i të dhënave në serverin e qendror të AKSHI- të jetë sa më i shpejtë dhe i sigurt.

Sa i përket sigurisë së të dhënave të sistemit ICMIS dhe dokumenteve të ndryshme elektronike të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, nga ana e IT përveç se kryhet rregullisht çdo ditë backupi i këtyre të dhënave, përdoret gjithashtu dhe teknologjia "Cloud Storage and File Backup Online". Kjo hapësirë administrohet nga IT e gjykatës.

III. Kryesekretaria dhe sekretarët gjyqësorë.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, për shkak të numrit të reduktuar të gjyqtarëve, po përballlet më një ngarkesë pune të konsiderueshme e cila sa vjen dhe është në rritje e sipër dhe reflekton edhe në veprimtarinë e përditshme të administratës gjyqësore. Kryesekretaria është sektori më i ngarkuar me punë administrative në këtë gjykatë dhe ka përgjegjësinë kryesore për shërbimet ndaj publikut. Megjithë përpjekjet maksimale konstatohet se numri i punonjësve që shërbejnë në Kryesekretari është i pamjaftueshëm. Kështu, puna voluminoze në Kryesekretarinë e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës gjatë vitit 2021 është përballuar nga Kryesekretarja dhe dy sekretare, një sekretare regjistruese dhe sekretarja pranë kryesekretarisë, të cilat për të përballuar volumin e madh të punës janë detyruar të punojnë çdo ditë jashtë orarit.

Gjithashtu, gjatë vitit 2021 kemi pasur shumë rekrutime të reja për pozicionin e “sekretares gjyqësore”, gjë e cila ka rritur ngarkesën e punës së nëpunësve të vjetra dhe më përvojë në gjykatë, pasi ato jo vetëm që kanë përballuar ngarkesën e gjykatës por dhe kanë asistuar njëkohësisht në dhënien e përvojës së tyre për punonjëset e reja.

Në vitit 2021 nga ana e Këshillit të Gjykatës me Vendimin Nr. 127 Prot., datë 05.07.2021 është ndryshuar orari i shërbimit në sportel duke krijuar orar të plotë shërbimi nga ora 08:00-16:00 për veprime të ndryshme me qytetarët dhe avokatët, duke vendosur njoftime me sqarime të nevojshme lidhur me çështje të caktuara, si dhe duke rritur në mënyrë të vazhdueshme efikasitetin dhe etikën e personelit të gjykatës në komunikimin me qytetarët. Puna voluminoze dhe zgjatja e orarit të shërbimit në sportel, ka sjellë për rrjedhojë një ngarkesë tejet të madhe dhe të papërballueshme nga ana e tre nëpunësve gjyqësorë në Kryesekretari.

IV. Arkiva.

Përsa i përket arkivës në këtë Gjykatë paraqitet një problematikë serioze që ka të bëjë me mungesën e hapësirave të mjaftueshme për të sistemuar arkivën e dosjeve penale dhe civile në një ambient të vetëm dhe të përshtatshëm. Në mungesë të hapësirave të përshtatshme, arkiva penale dhe civile është e shpërndarë në disa ambiente të ndryshme të gjykatës.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës nuk ka ambiente të mjaftueshme për vendosjen e dosjeve gjyqësore, dhe një pjesë e tyre madje janë vendosur në garazhet e gjykatës, pasi nuk ka asnjë ambient tjetër të përshtatshëm për këto dosje.

Pavarësisht ambienteve të papërshtatshme, gjatë vitit 2021 janë marrë masa për të përmirësuar kushtet në arkiv. Janë vendosur aparate për matjen e temperaturës dhe lagështirës dhe regjistra për matjen e temperaturës së ambientit në të cilin shënohen çdo ditë të dhënat e nevojshme për të mbajtur në kontroll kushtet klimaterike.

Gjatë vitit 2021, kemi vazhduar me përpunimin dhe dërgimin e dokumentacionit nga viti më i hershëm për transferimin e dokumentacionit sipas anekseve të miratuara me Urdhrin Nr. 4895/4 Prot., datë 01.11.2016 në ASHSGJ Lundër.

Për vitin 2021 konkretisht, Arkiva ka kryer të gjitha procedurat dhe me Urdhrin Nr. 99 Prot., datë 28.06.2021 është urdhëruar transferimi i dosjeve gjyqësore civile me afat ruajtje të përhershëm nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës në Arkivin Shtetëror të Sistemit Gjyqësor.

- Për Kodin 1-004 (Pronësia)-vitet 2007-2009-janë dorëzuar 2733 dosje të organizuara në 114 kuti.
- Për Kodin 1-001 (Trashëgimia)-vitet 2007-2009-janë dorëzuar 2528 dosje të organizuara në 70 kuti.

- Për Kodin 1-002 (Atësia)-vitet 2007-2009-1 dosje të organizuar në 1 kuti.
- Për Kodin 1-003 (Birësimi)-vitet 2007-2009-16 dosje të organizuara në 1 kuti.

Në total, për vitin 2021 kemi transferuar 5278 dosje gjyqësore civile me afat ruajtje të përhershëm. Për vitin 2022, jemi në fazë përpunimi të këtyre dosjeve civile, specifikuat viteve 2010 dhe 2011, për të cilat do bëhen të gjitha fazat e njëpasnjëshme të kësaj procedure.

Gjithashtu vlen të përmendet se në muajin Nëntor 2021 ka filluar nga KLGJ hartimi i procesit të asgjësimit të dosjeve gjyqësore. Për këtë, në bazë të Urdhrit Nr. 117 Prot., datë 06.10.2021 të KLGJ-së *“Për ngritjen e grupit të përbashkët të punës për hartimin e listës së dokumentave tip dhe afatet e ruajtjes për sistemimin e arkivimit gjyqësor”*, ne si Gjykatë jemi pjesëmarrës në këtë grup të ngritur në KLGJ. Aktualisht jemi në fazën e realizimit të kësaj procedure dhe jemi në fazë përpunimi.

V. Dega e Buxhetit.

Gjatë vitit 2021 ndër detyrat e tjera administrative dhe financiare kjo zyrë ka arkëtuar për interes të Shtetit të ardhurat në formën e taksave të padive dhe taksat mbi aktet dhe shërbimet gjyqësore, garancitë etj. të cilat në total arrijnë vlerën 18.284.595 (tetëmbëdhjetë milion e dyqind e tetëdhjetë e katërmijë e pesëqind e nëntëdhjetë e pesë) Lekë të derdhura në Buxhetin e Shtetit.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës rezulton të jetë mjaft efektive në vjeljen që në momentin e dorëzimit të kërkesë-padive dhe kërkesave të tjera të taksës gjyqësore dhe shpenzimeve të njoftimit.

Që nga 1 Janar 2015 dhe në vazhdim Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës është përfshirë në projektin e Gjykatave të cilat aplikojnë sistemin financiar elektronik Alpha WEB, i cili duke qenë një program bashkëkohor, mundëson informacionin kontabël të nevojshëm dhe domosdoshëm sipas të gjitha kërkesave të legjislacionit në fuqi.

Në bashkëpunim me KLGJ aktualisht po punohet për të kaluar në një sistem të ri financiar, *“kreatex flare”* nga i cili shpresojmë që të mundësojë të gjithë informacionin e nevojshëm kontabël duke u përshtatur me kërkesat dhe ndryshimet që kërkon koha.

Në Mars 2018 Gjykatës i është miratuar 1 (një) punonjës definitiv në pozicionin e ekonomistit. Ky pozicion bën që struktura e financës të jetë më e plotë dhe ti përgjigjet në kohë dhe efektivitet të gjitha kërkesave dhe ndryshimeve në kohë.

Organigrama e financës tani përbehet nga 2 punonjës. Kryetare e Degës së Buxhetit është punonjësi që kryen kontrollin e dokumentacionit dhe pranimin i tij përpara njohjes së shpenzimit në kontabilitet dhe punonjësi i dytë ekonomisti, bën regjistrimet në kontabilitet të transaksionit financiar.

Shtimi i një punonjësi në strukturën e financës bën plotësimin e kësaj strukture si rezultat sjell raportimin në kohë për vendimmarrjen në funksion të realizimit të objektivave, ruajtjen dhe mbrojtjen e aktiveve dhe të dokumentacionit të njësisë, garanton mbledhjen e të gjitha borxheve të pa arkëtuara, pagesën në kohë të të gjithë kreditorëve etj.

Si rezultat garanton zbatimin e Ligjit Nr. 10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*" (ndryshuar me Ligjin Nr. 110/2015).

Problematikë jo vetëm e gjykatës tonë mbetet mospasja e një mënyre matjeje të shpenzimeve gjyqësore sa i takon koston të gjykimit, apo koston së shtyrjes së seancës gjyqësore, e cila aktualisht barazohet vetëm me shpenzimet për njoftimet e palëve. Ndërkohë, në vendet e tjera një kosto e tillë përlllogaritet me koston e punës së paguar të gjyqtarit dhe administratës gjyqësore, si dhe me matës të tjerë, të cilët janë të nevojshëm për analizën e koston më pas. Mbetet për t'u parë në të ardhmen përgatitja dhe vënia në funksionim nga ana Këshillit të Lartë Gjyqësor e një mënyre për përlllogaritjen e kostove të mësipërme.

Nga kjo anë do të merren masa nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës në bashkëpunim me Këshillin e Lartë Gjyqësor që të saktësohet, formalizohet dhe unifikohet formati i llogaritjes së shpenzimeve gjyqësore dhe kodifikimi i tyre sipas gjyqtarëve dhe të mundësohet shtimi i një opsioni në sistemin elektronik të menaxhimit të çështjeve gjyqësore, ku të evidentohet vlera e objektit të padisë, tarifa gjyqësore dhe pagesa e saj, në mënyrë që të sigurohet kontrolli i kësaj të ardhure.

Po kështu, lidhur me këtë çështje mbetet problematike përcaktimi i tarifave për pagesën e avokatëve kryesisht, psikologëve, përkthyesve dhe ekspertëve mbi bazën e seancave gjyqësore apo orëve të punës, përlllogaritje e cila do të ishte më e saktë, duke garantuar edhe një trajtim të barabartë të tyre në raport me shërbimin e ofruar.

Një problematikë tjetër që kemi hasur gjatë vitit 2021 është vjelja e detyrimeve nga qytetarët për pagesën e shërbimeve të parapaguara të kadastrës.

Sipas VKM Nr. 389, datë 13.05.2020 "*Për miratimin e listës dhe tarifave të shërbimeve kadastrale*" gjykata është e detyruar të paguajë faturat e fiskalizuar të kadastrës për shërbimet kadastrale të nevojshme në proceset gjyqësore.

VKM-ja në fjalë parashikon mënyrën e aplikimit dhe tarifat standarde për çdo shërbim të kadastrës, por nuk rregullon mënyrën e pagesës së kësaj tarife nga qytetari si kërkues i shërbimit.

Në këto kushte gjykata ka hasur mjaft vështirësi në mbledhjen e detyrimeve për këto shërbime nga qytetarët të cilët janë palë në procese gjyqësore.

Dhe në fund një domosdoshmëri mbetet edhe ngritja e njësisë së prokurimit, e cila të ketë njohuritë dhe trajnimin e nevojshëm për të siguruar një ecuri normale të proceseve të prokurimit të shërbimeve dhe mallrave në institucion, njësi e cila për shkak të pamjaftueshmërisë së stafit administrativ është ngritur çdo vit në mënyrë të përkohshme, për realizimin e procedurave të tenderimit, por nuk është një strukturë e përhershme.

VI. PROGRAMI I TRANSPARENCËS.

Aksesi në Gjykatë është një ndër pikat kyçe të cilës së fundmi i është kushtuar një rëndësi e veçantë. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, në përputhje me legjislacionin, në kuadër të përshtatjes edhe të situatës së krijuar (tërmet, pandemi etj.) me qëllim aksesin në gjykatë, shmangien e vonesave, marrjen e shërbimeve nga përdoruesit/qytetarët, vijimin e veprimtarisë administrativo-gjyqësore, ka krijuar kushtet e nevojshme për aksesimin on-line të një sërë shërbimesh në gjykatë të cilat i ofrohen përdoruesve.

Sa më sipër, nëpërmjet faqes zyrtare të Gjykatës përdoruesit mund të ndjekin ecurinë e gjykimeve në proces shqyrtimi në të cilat janë palë ndërgjyqëse, mund të aksesojnë një sërë të dhënash statistikore për qëllime studimore, për transparencë etj., mund të shohin në kohë reale shortin elektronik, fazën e gjykimit të çështjes për të cilën janë të interesuar, mund të shikojnë datën e seancës së ardhshme, vendimet përfundimtare etj.

Gjithashtu është zgjeruar mënyra e kërkimit të informacionin në gjykatë si për kërkimet e informacionit po ashtu edhe dokumentacionit.

Aktualisht përdoruesit për marrjen e informacionit dhe dokumentacionit nga Gjykata mund të aplikojnë direkt në *"Formularin për marrjen e dokumentacionit nga Gjykata"* i cili gjendet në faqen zyrtare të gjykatës si dhe mund të bëjnë kërkesë në postën elektronike të gjykatës zmp.gjykatarrrethitdurrës@gjykata.gov.al.

Këshilli i Lartë Gjyqësor si një risi për vitin 2021-2022, në rolin e organit qeverisës për sistemin gjyqësor, ka ndërmarrë një sërë projektesh në fushën e teknologjisë, me qëllim ofrimin e shërbimeve inovative për gjyqësorin. Një ndër këto projekte, është edhe projekti "Formulari elektronik i aplikimit".

Në kuadër të përmirësimit të shërbimit, dhe masave anti Covid-19, ky shërbim elektronik u vjen në ndihmë qytetarëve/përdoruesve të gjykatës që të dërgojnë një aplikim, për tu pajisur me kopje të dokumenteve gjyqësore të tilla si, kopje vendimi viti aktual, kopje vendimi (arkiva), kopje të dosjeve gjyqësore, vërtetim për çështje në proces gjykimi (individ), vërtetim për çështje në proces gjykimi (shoqëri tregtare), vërtetim për ndjekje penale.

Formulari online i aplikimit, është shtuar tashmë si rubrikë e re, në profilin e çdo gjykate, në portalin www.gjykata.gov.al.

Të dhënat e grumbulluara nga aplikimet, përpunohen dhe ruhen në përputhje të plotë me parashikimet e ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 *"Për mbrojtjen e të dhënave personale"*.

Për të nisur procesin e aplikimit për një nga dokumentet e sipërcituara, kërkuesi, plotëson të gjitha informacionet e kërkuara brenda këtij formulari on-line. Pas dërgimit të aplikimit drejt gjykatës, ai procesohet nga nëpunësi i gjykatës, dhe në varësi të informacionit, kthimi i përgjigjes dhe i materialeve të kërkuara nga kërkuesi kryhet duke u paraqitur pranë ambienteve të gjykatës ose kur është rasti ato përcillen elektronikisht pa qenë nevoja e paraqitjes fizikisht në gjykatë.

Referuar sa më sipër, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës po bashkëpunon me Këshillin e Lartë Gjyqësor me qëllim implementimin sa më të saktë lidhur me komunikimin elektronik, me qëllim trajtimin e këtyre kërkesa që do të vijnë nga ky shërbim i ri.

Në përputhje me nenin 7 të ligjit Nr. 119/2014 *"Për të drejtën e informimit"* në faqen zyrtare është publikuar programi i transparencës për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës.

Nëpërmjet këtij programi përcaktohet korniza ligjore e veprimtarisë së autoritetit në kuadër të ligjit Nr. 119/2014 *"Për të drejtën e informimit"*.

Informacioni i bërë publik në këtë program, synon të bëjë transparencën e veprimtarisë së punës së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, nëpërmjet pasqyrit të tij në faqen zyrtare <http://www.gjykata.gov.al> si dhe në mjediset e pritjes së publikut.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës është një institucion që ka marrë të gjitha masat për respektimin maksimal të të gjitha detyrimeve të rrjedhura nga ky ligj, duke publikuar në faqen e saj elektronike zyrtare të gjithë informacionin dhe dokumentacionin e disponuar prej saj, të parashikuar nga ligji si të detyrueshëm për publikim.

Dokumentacioni i bërë publik, është i përditësuar në formë e përmbytje. Faqja zyrtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës është ndërtuar në atë formë që mundëson informacion për publikun pa kërkesë në format lehtësisht të kuptueshëm në bashkëpunim me specialistin e IT-së përditësohet nga data e krijimit të saj referuar kërkesave të publikut të bazuara në Ligjin Nr. 119/2014 *"Për të drejtën e informimit"*.

Koordinatori për të drejtën e informimit përpunon të gjitha kërkesat, kthen përgjigje në rrugë elektronike dhe jep orientimet e nevojshme për qytetarët që të mund të drejtohen pa vështirësi në gjykatë që të marrin informacionin e nevojshëm me anë të fletë-palosjeve, formularëve apo informacionit që gjendet në faqen zyrtare të gjykatës, ndërkohë urdhrat proceduralë apo akte të tjera administrative që kanë të bëjnë me procedurat në gjykatë, janë publikuar rregullisht në faqen e internetit të gjykatës.

Gjatë vitit 2021 janë trajtuar 15 kërkesa në përputhje me ligjin “Për të drejtën e informimit”. Në asnjë rast nuk është ushtruar ankim tek Komisionari për të Drejtën e Informimit.

Sa me sipër në faqen zyrtare të internetit është publikuar dhe formati i ri programit të transparencës sipas udhëzimeve dhe manualit të përgatitur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor.

Në vijim të sa mësipër, në funksion të analizës së punës për vitin 2021, treguesit e punës do të trajtohen në këto drejtime:

- Volumi i çështjeve civile dhe penale për gjykim gjatë vitit 2021;
- Shpejtësia në gjykim;
- Marrëdhëniet me institucionet e tjera me të cilat lidhet puna e gjykatës.

1. VOLUMI I ÇËSHTJEVE

Gjatë vitit 2021 në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës janë paraqitur gjithsej për gjykim 8666 çështje nga të cilat: 3358 (38%) çështje themeli penale e civile; 5188 (62 %) kërkesa administrative penale e civile nga të cilat: 2590 kërkesa për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit, 726 kërkesa gjatë fazës së hetimeve paraprake dhe 1203 kërkesa në Seancë Paraprake. (Grafiku Nr. 1/Tabela Nr. 1).

Numri i seancave të zhvilluara dhe regjistruara sipas të dhënave të Sistemit Elektronik PAKS+ për vitin 2021 për shqyrtimin e çështjeve në total është 21731 seanca, ndërsa numri i seancave për vitin 2020 është 15739. Rritja e numrit të seancave me 5992 lidhet përveç se me ndryshimet në K.Pr.Penale dhe K.Pr.Civile si dhe për shkak të pandemisë së COVID-19.

Numri i seancave audio 7787, e shprehur në përqindje numri i seancave audio për periudhën 1 Janar 2021 deri me 31 Dhjetor 2021, ka qenë 35.8%, ndërsa diferenca është mbajtur në zyrat e gjyqtarëve për shkak të mungesës së sallave të gjykim dhe volumit të madh të seancave që zhvillohet në një ditë.

Gjithashtu nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës janë marrë të gjitha masat për reduktimin e seancave joproduktive në kuadër të Nismës “Drejtësi pa vonesa”.

Sipas Komisionit Evropian për Eficencën në Drejtësi (CEPEJ) për të analizuar e të dhënat statistikore në tërësi përdoren 2 indikatorë që janë Clearance Rate (CR indicator) i cili tregon raportin midis çështjeve të regjistruara me çështjet e përfunduara në përqindje dhe Disposition Time (DT) i cili tregon raportin e shpejtësisë së përfundimit të çështjeve gjyqësore të ardhura në gjykatë në ditë.

Për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës rezulton se Clearance Rate për çështjet Penale (Treguesi Normale përfundimit/Likuidimit e çështjeve) gjatë vitit 2021 është 99.3 % dhe Clearance Rate për çështjet Civile është 95.2 %.

Koha e nevojshme për përfundimin e një çështje penale për vitin 2021 është 72 ditë dhe për çështjet civile është 102 ditë.

Clearance rate penal (Treguesi Norma e Përfundimit/Likuidimit të Çështjeve)

$$R_{\text{penale}}^{2021} = \frac{\text{numri i çështjeve të përfunduara}}{\text{numri i çështjeve të reja}} * 100 = \frac{3275}{3295} * 100 = 99.3 \%$$

Clearance rate Civil (Treguesi Norma e Përfundimit/Likuidimit të Çështjeve)

$$R_{\text{civile}}^{2021} = \frac{\text{numri i çështjeve të përfunduara}}{\text{numri i çështjeve të reja}} * 100 = \frac{5117}{5371} * 100 = 95.2 \%$$

Average disposition time penale (Koha e nevojshme për Përfundimin/Likuidimin e Çështjeve)

$$\begin{aligned} T_{\text{penale}}^{2021} &= \frac{\text{numri i çështjeve në pritje për gjykim më 31.12.2020}}{\text{numri i çështjeve të zgjidhura}} * 365 \\ &= \frac{654}{3275} * 365 = 72 \end{aligned}$$

Average disposition time civile (Koha e nevojshme për Përfundimin/Likuidimin e Çështjeve)

$$\begin{aligned} T_{\text{civile}}^{2021} &= \frac{\text{numri i çështjeve në pritje për gjykim më 31.12.2020}}{\text{numri i çështjeve të zgjidhura}} * 365 \\ &= \frac{1436}{5117} * 365 = 102 \end{aligned}$$

Totali për secilin gjyqtar për vitin 2021

Nr.	Gjyqtari	Çështje të gjykuara	Çështje të caktuara	Numri i çështjeve deri me datë 31.12.202 1	Clearanc e rate në %	Case dispositio n time në ditë
1	Paulin Çera	806	986	59	81.7	48
2	Markelian Koça	79	960	291	77.4	166
3	Rexhep Bekteshi	880			91.6	67
4	Dhurata Bilo	110	597			
5	Eda Kaja	731	901	398	122.4	66
6	Flora Hasimi	764	998	283	84.7	124
7	Shpëtime Pitaku	987	960	279	102.8	103
8	Shpëtim Reka	941	1072	350	98	100
9	Vladimir Skënderi	907	1043	166	86.9	66
10	Petraq Çurri	1006	974	251	96.4	29
11	Besjana Garxenaj	826	960	59	84.8	45
12	Nurjeta Tafa	355	73		486.3	289
	TOTALI	1230	7722	7372		


Sqarim: Gjyqtarja Znj. Dhurata Bilo dhe Znj. Eda Kaja janë shkarkuar nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit.

Dosjet e Gjyqtarës Znj. Nurjeta Tafa janë ri-shortuar për shkak të marrjes prej saj së lejes së lindjes.

Çështjet në shqyrtim të këtyre gjyqtareve janë ri-shortuar dhe janë aktualisht në shqyrtim nga gjyqtarët e tjerë në detyrë, të cilëve në tabelën e mësipërme janë shtuar si ngarkesë në shqyrtim.

Grafiku Nr. 1


Grafiku i ngarkesës për gjykatën në tërësi



Konstatohet se në numrin total të çështjeve për gjykim në vitin 2021 ka rritje të konsiderueshme të numrit të çështjeve nga viti 2020, nga 7130 çështje gjatë vitit 2020 në 8666 gjatë vitit 2021.

Grafiku Nr. 2

Nr. I çështjeve për gjykim themeli



Ngarkesa e seksionit penal vijon të jetë e madhe duke marrë parasysh dhe ndryshimet e reja të Kodit të Procedurës Penale të cilat kanë rritur rolin e gjykatës, konkretisht gjyqtari i seksionit penal shqyrton masat e sigurimit dhe çdo kërkesë tjetër që i paraqitet gjatë fazës së hetimeve paraprake, kërkesat në seancë paraprake me objekt dërgimin e çështjeve për gjykim, kërkesa për pushimin e çështjeve apo miratimin e urdhrat penal.


Sa i përket çështjeve civile themeli vërehet rritje e lehtë nga 2422 në vitin 2020 në 2489 në vitin 2021 dhe për çështje penale nga 828 çështje në vitin 2020 dhe 989 në vitin 2021. (Grafiku Nr. 3).

Në Dhomën Civile është riorganizuar puna e gjykatës me qëllim që secili seksion brenda kompetencave të tij të shqyrtojë çështjet që i takojnë sipas ligjit, konkretisht: Seksioni civil do të shqyrtojë çështjet civile, kërkesat civile dhe të gjithë urdhrat ekzekutimit, seksioni familjar do të shqyrtojë të gjitha urdhrat e menjëhershëm të mbrojtjes dhe çështje familjare, ndërsa seksioni tregtar do të shqyrtojë të gjitha çështjet tregtare.

Grafiku nr. 3

Grafiku krahasues për volumin e çështjeve të themelit.

Numri i çështjeve për gjykim themeli



■ Çështje civile themeli	2789	3150	3395	3372	2422	2489
■ Çështje penale themeli	1298	1013	1129	1047	828	989

Nëse do t'i referohemi numrit total të çështjeve të themelit të shqyrtuara gjatë vitit 2021 rezulton se nga 3478 çështje themeli, 1582 (809 civile dhe 773 penale) janë mbartur nga vitit 2020 dhe 8666 (5571 civile dhe 3295 penale) janë regjistruar gjatë vitit 2021. Nga këto çështje ka përfunduar gjykimi i 8392 ose 96.8 % prej tyre.

Ndërkohë, 1055 çështje civile janë mbyllur me vendim jopërfundimtar nga ana e gjykatës në raste të tilla si: kur është vendosur pushimi i çështjes për shkak të zgjidhjes së saj jashtë gjyqësisht, pushimit të çështjes për shkak të heqjes dorë nga gjykimi i padisë, pushimit për shkak të mosparaqitjes së paditësit apo ankuesit, vendime pezullimi, pushim për shkak të tërheqjes së të dëmtuarit akuzues në rastin e veprave penale që gjykohen mbi ankimin e këtij të fundit, shpalljes së moskompetencës tokësore apo lëndore, etj.

Një pjesë e madhe e vendimeve jopërfundimtare sërish i takon seksionit civil, ku për shkak të paqartësive lidhur me kompetencën lëndore të një kategorie të çështjeve deri në vendimmarrjen e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nga ana e gjyqtarëve është deklaruar moskompetenca lëndore, duke iu dërguar aktet Gjykatës Administrative dhe anasjelltas.

Lidhur me llojin e natyrës së çështjeve, nga të dhënat statistikore rezulton se në kategorinë e çështjeve civile gjatë vitit 2021 janë gjykuar 1634 çështje civile të përgjithshme me palë kundërshtarë, 601 çështje familjare me palë kundërshtarë, 586 çështje me objekt "Zgjidhje Martese", si dhe 18 çështje "Marrëdhënie pune".

Ende ngarkesa më e madhe në Dhomën Civile i përket Seksionit Familjar, ku numri i padive me objekt “Zgjidhjen e martesës” paraqitet më i lartë se çdo kategori tjetër të dhëna të cilat tregojnë se pjesa dërrmuese e padive të themelit janë ato që kanë si objekt zgjidhjen e martesës.

Në Seksionin Civil paditë gjatë fazës së ekzekutimit paraqesin numrin më të lartë të padive, ku objektet e kundërshtimit të veprimeve përmbarimore apo pavlefshmërisë së titujve ekzekutivë janë paditë kryesore të shqyrtuara gjatë vitit 2021.

Nga ana tjetër, sa i takon natyrës së çështjeve penale me ndryshimet me Ligjin Nr. 35/2017 në K.Pr.Penale, është rritur numri i kërkesave të seancës paraprake si kërkesa penale për dërgimin e çështjes në gjyq, kërkesa për pushimin e çështjes penale për krime apo ankim ndaj vendimit të pushimit të çështjes për kundërvajtje penale. Në vitin 2021 janë paraqitur gjithsej për gjykim 1203 kërkesa të seancës paraprake, nga të cilat ka përfunduar gjykimi për 954 çështje. (Tabela Nr. 3/a)

Për çështjet penale themeli numri më i madh i tyre i takon veprës penale të parashikuar nga neni 130/a i Kodit Penal me 111 të dënuar, vepra penale për Nenin 199/a të K.Penal me 59 të dënuar, për Nenin 291 të K.Penal me 282 të dënuar, ndjekur nga çështjet kundërvajtje penale referuar nenit 189 i Kodit Penal me 22 të dënuar. (Tabela Nr. 4)

Ndërkohë, më datë 22.04.2021, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit vendosi shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Dhurata Bilo, gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, e cila ka gjykuar në Seksionin Civil sipas Vendimit nr. 7 prot., datë 31.07.2019 *“Mbi shpërndarjen e gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës në seksione e trupa gjykues” (i ndryshuar)*.

Gjithashtu, me Vendimin Nr. 85, datë 24.05.2021, është vendosur përjashtimi nga shorti i gjyqtarës Nurjeta Tafa deri në një urdhër të dytë pas rikthimit e saj në punë nga leja e lindjes.

Me largimin e gjyqtarës Dhurata Bilo dhe përjashtimin nga shorti të gjyqtarës Nurjeta Tafa e cila pas javës së dytë të muajit korrik 2021 largohet me leje nga puna, seksioni civil praktikisht mbetet me 4 gjyqtarë, çka vjen në kundërshtimin me nenin 23 të Ligjit Nr. 98/2016 *“Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”*, sipas së cilit rezulton: *“... Seksionet e gjykatave përbëhen nga së paku gjashtë gjyqtarë”*.

Ndodhur në këtë situatë, Këshilli i Gjykatës, në mbledhjen e datës 24.05.2021, miratoi në unanimitet bashkimin e seksionit civil dhe seksionit penal në një seksion të vetëm duke riorganizuar edhe shpërndarjen e gjyqtarëve në trupa gjykues.

Pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, në Dhomën Penale funksionon Seksioni për të Mitur, i cili përbëhet nga gjyqtarë të specializuar në këtë fushë, që gjykojnë njëkohësisht edhe çështjet për të rritur.

Gjyqtarët e Seksionit për të Mitur gjykojnë njëkohësisht dhe çështje për të rritur.

Në datën 1 janar 2018 kanë hyrë në fuqi dispozitat e Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur dhe përmbajnë rregullime të posaçme lidhur me përgjegjësinë penale të të miturve, rregulla procedurale lidhur me hetimin, ndjekjen penale, procesin gjyqësor, ekzekutimin e vendimit të dënimit penal, rehabilitimin ose të çdo mase tjetër që përfshin një të mitur në konflikt me ligjin, si dhe një të mitur viktimë dhe/ose dëshmitar të veprës penale.


Gjatë vitit 2021 në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës janë regjistruar 33 çështje penale ku të pandehur kanë qenë persona të mitur dhe kanë përfunduar gjatë këtij viti 33 çështje. Në caktimin e masave të dënimit është aplikuar Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur dhe në rastet e tjera janë aplikuar dënimet alternative sipas Kodit Penal. (Tabela Nr. 3/b)

Lidhur me llojin dhe masën e dënimit të aplikuar nga gjykata në çështjet penale të gjykuara gjatë vitit 2021, referuar të dhënave të Tabelës Nr. 5 konstatohet se lloji më i përhapur i dënimit është ai me burgim deri në 2 vjet (316 raste), ndjekur nga dënimi me gjobë (152 raste) dhe ai me burgim 2-5 vjet (55 raste).

Ndërkohë, gjatë vitit 2021 dënimet alternative rezultojnë të jenë aplikuar nga gjykata në 538 raste, ndër të cilat 457 është aplikuar neni 59 i Kodit Penal (pezullim i ekzekutimit të dënimit me burgim), në 74 raste gjykata ka vendosur punë me interes publik (neni 63 i Kodit Penal). (Tabela nr. 5)

Lidhur me disponimet e gjykatës për “Masat e sigurimit personal” janë të paraqitura grafikisht si me poshtë:

Grafiku i masave të sigurimit



Vlen të theksohet se analiza matematike e treguesve të mësipërm do të çonte në një mesatarizim mekanik të punës të një gjyqtari gjatë vitit 2021, si referuar si ngarkesës së gjyqtarit, ashtu edhe natyrës së çështjeve të gjykuara nga ai, kjo si për shkak të ligjit material, ashtu edhe për shkak të ligjit procedural, ku rol të veçantë luan procesi i të provuarit.

Kështu, përgjithësisht gjykimi i çështjeve penale është më i shpejtë për shkak se së paku në mbi 85% të rasteve procedohet me gjykim të shkurtuar. Nga ana tjetër, edhe kërkesa administrative penale paraqesin lehtësi me të madhe se kërkesat civile si nga pikëpamja procedural, ashtu edhe nga pikëpamja e provueshmërisë.

Sa i përket gjykimeve të tjera të posaçme pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës gjatë vitit 2021 janë paraqitur për gjykim 87 kërkesa për gjykim të drejtpërdrejtë.

Nëse i referohemi ngarkesës individuale për çdo gjyqtar konstatohet lehtësisht se numri më i madh i çështjeve të gjykuara vazhdon t'u përkasë edhe gjatë vitit 2021 gjyqtarëve të seksionit civil, në një kohë që referuar edhe treguesve të tjerë të punës rezulton se ngarkesa në numër e çështjeve nuk reflektohet në ngarkesë reale të këtij seksioni, përse kohë ngarkesa nuk mund të përcaktohet vetëm nga numri i çështjeve, por nga një sërë faktorësh. (Tabela. Nr.3)

Nga Janari 2021 e deri në Dhjetor 2021 në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës kanë ushtruar efektivisht detyrën, duke marrë pjesë edhe në short, gjithsej 12 gjyqtarë, të cilët në periudha të caktuara mund të kenë qenë të përjashtuar nga shorti për shkak të mungesës në punë për arsye shëndetësore.

Referuar të dhënave statistikore të detajuara në Tabelën Nr. 3 mund të bëhet një mesatarizim i punës së gjyqtarëve, sipas ndarjes së tyre në Dhoma e Seksione, natyrës së çështjeve, si dhe pjesëmarrjes në përbërje të trupave gjykues si antarë.

Konkretisht, për gjyqtarët e Dhomës Penale mesatarja e çështjeve për gjykim (penale, administrative penale dhe masa sigurimi) ka qenë 549 çështje; mesatarja e çështjeve të gjykuara në përbërje të trupave gjykues si anëtarë ka qenë 10 çështje për gjyqtar.

Sa i takon Dhomës Civile, për Seksionin Civil/Tregtar, mesatarja për gjyqtar ka qenë 895 çështje. Mesatarja e kërkesave e pjesëmarrjes në trupa gjykues ka qenë 13 çështje për gjyqtar.

Nga analizat e të dhënave vërehet rritje e ndjeshme e kërkesave të gjyqtarëve për heqje dorë nga gjykimi i çështjeve krahasuar me vitet paraardhëse. Shkaqet kryesore të heqjes dorë nga gjykimi i çështjeve lidhen me pjesëmarrjen e gjyqtarëve në procese të tjera


gjyqësore të lidhura apo vendimmarrje të mëparshme ku janë shprehur me vlerësime nga të cilat cenohet paanësia.

Pjesa tjetër e rasteve të heqjes dorë nga gjykimi por më e paktë lidhet me vlerësimin e ekzistencës së arsyeve të tjera serioze të njëanshmërisë.

Gjatë vitit 2021 janë shqyrtuar nga Zëvendëskryetari i Gjykatës 211 “Kërkesa për heqje dorë”, mesatarisht 17 kërkesa për gjyqtar nga të cilat 124 kërkesa janë miratuar. (Grafiku 3/a | Tabela 3/c).

Grafiku nr. 3/a

Kërkesa për heqje dorë ndër vite



Kërkesat për përjashtimin e gjyqtarit janë paraqitur gjithsej 99, nga të cilat 18 kërkesa për përjashtimin e gjyqtarit në proces penal dhe 71 kërkesa për përjashtimin e gjyqtarit në proces civil.(Grafiku Nr. 3/b). Gjatë vitit 2021 ka pasur gjithsej 26 kërkesa për përjashtim gjyqtari më kërkesë të palëve, ku 7 kërkesa janë pranuar dhe 19 janë refuzuar.

Për vitin 2021 të gjithë gjyqtarët e gjykatës sonë kanë qenë të deleguar për gjykime në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë. Gjyqtari Rexhep Bekteshi ka qenë i deleguar dhe në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar .

Grafiku Nr. 3/b



2. SHPEJTËSIA NË GJYKIM

Përsa i përket shpejtësisë në gjykim, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës paraqet tregues të kënaqshëm në funksion të dhënies së drejtësisë, brenda një afati të arsyeshëm kohor sipas detyrimeve procedural dhe parashikimeve kushtetuese të nenit 42/2 dhe nenit 6§1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Një pengesë në shpejtësinë e gjykimit edhe në vitin 2021 e bën sistemi i shërbimit postar të njoftimeve, shtrirja e gjerë territoriale në të cilën ushtron veprimtarinë Gjykata dhe mungesa e një sistemi të saktë adresash.

Faktorët e jashtëm që kanë ndikuar në shpejtësinë në gjykim janë kërkesat e palëve për tu mbrojtur me avokat pa e siguruar një mbrojtje të tillë para se të fillojë procesi gjyqësor dhe për të paraqitur prova, paraqitja e kërkesave për shtyrje të seancës, nisur nga pjesëmarrja në gjykim tjetër etj.


Ndër faktorët e tjerë të brendshëm që ndikojnë në shpejtësinë e gjykimit është ngarkesa shumë e lartë në punë për secilin gjyqtar, referuar numrit mesatar të çështjeve për gjyqtar dhe organikës së gjykatës, numrit të delegimeve të gjyqtarëve në gjykata të tjera.

Lidhur me shpejtësinë në gjykim, kanë përfunduar deri në 6 muaj 88 % e çështjeve penale, kanë përfunduar brenda periudhës 6 muaj - 1 vit 7% e çështjeve dhe 5% e çështjeve ka përfunduar mbi 1 vit. (shih Grafikun Nr.4/ Tabela Nr. 6).

Grafiku Nr. 4

Grafiku bazuar në numrin e seancave: Penale


Grafiku bazuar në kohëzgjatjen e seancave Penale



Ndërkaq, kanë përfunduar për periudhën deri në 6 muaj 81% e çështjeve civile, kanë përfunduar brenda periudhës 6 muaj - 1 vit 11% e çështjeve, ndërkohë që në periodhat mbi 1 vit kanë përfunduar vetëm 8% e tyre (Shiko grafikun Nr. 5/tabela 6).

Grafiku Nr. 5


Grafiku bazuar në kohëzgjatjen e seancave: Civile



Grafiku nr. 6

Grafiku bazuar në kohëzgjatjen e seancave: Civile dhe Penale

Kohëzgjatja e çështjeve në tërësi



Ndër faktorët kryesorë që ndikojnë në shpejtësinë e gjykimit padiskutim më i rëndësishmi mbetet sistemi i adresave, i cili i lidhur me ndryshimet procedurale ka ndikuar në kohëzgjatjen e gjykimit.

Megjithatë, në shpejtësinë e gjykimit ndikojnë edhe faktorë të tjerë, menaxhimi i çështjes për gjykim nga ana e vetë gjyqtarit, lloji i gjykimit (gjykimi i shkurtuar ose i drejtpërdrejtë në çështjet penale dhe ai i kërkesave civile), kompleksiteti i çështjes, realizimi i njoftimeve të rregullta të palëve e dëshmitarëve, përgjigja e institucioneve publike e private, etj., faktorë ndër të cilët vend të veçantë zë edhe sjellja e palëve ndërgjyqëse gjatë gjykimit, çka rezulton ende të jetë shkak kryesor për shtyrjen e seancave gjyqësore.

3. MARRËDHËNIET ME INSTITUCIONET E TJERA DHE PUBLIKUN

Si një ndër institucionet kryesore me të cilat gjendet në marrëdhënie të vazhdueshme pune, marrëdhëniet me prokurorinë pranë kësaj gjykate kanë qenë në fokus të vazhdueshëm në funksion të përmirësimit të proceseve të punës dhe zgjidhjes së problematikave të hasura.

Veçanërisht rëndësi i është kushtuar dorëzimit të vendimeve brenda afatit ligjor, komunikimit të tyre palëve dhe dërgimit të dosjeve në gjykatën e apelit, problematikë kjo e mëparshme, e ngritur si shqetësim nga ana e Prokurorisë.

Po kështu, është arritur zgjidhja e problematikave të ndërsjella nëpërmjet bashkëpunimit dhe përcjelljes së shqetësimeve ndër dy institucionet, çka ka çuar në përmirësim të vazhdueshëm të procesit të punës. Rëndësi e veçantë i është kushtuar vendosjes së praktikave në lidhje me zbatimin sa më korrekt dhe efektiv të ndryshimeve procedurale.

Sjellja e prokurorëve reflektohet përgjithësisht korrekte, duke u evidentuar raste jo të shpeshta të mospjesëmarrjes në gjykim pa njoftuar paraprakisht gjykatën, apo paraqitjes me vonesë në fillimin e seancës gjyqësore. Megjithatë, vlen të theksohet se përgjithësisht problematikat e ngritura respektivisht nga të dy institucionet kanë gjetur përgjigje.

Sa i takon marrëdhënieve me Dhomën e Avokatisë Durrës, përgjithësisht nga ana e avokatëve është reflektuar sjellje korrekte përsa i përket solemnitetit dhe orarit të gjykimeve. Në raste të veçanta gjyqtarët kanë njoftuar Dhomën e Avokatisë për marrjen e masave ndaj avokatëve konkretë. Problem mbetet shlyerja e pagimit të gjobave nga ana e avokatëve, në rastet e caktuara nga gjykata.

Nga ana tjetër, në kuptim të Nenit 49/3 të Kodit të Procedurës Penale, Dhoma e Avokatisë Durrës ka paraqitur rregullisht *"Listën e avokatëve të gatshëm për t'u caktuar kryesisht"*, e cila përgjithësisht respektohet nga gjyqtarët në varësi të ngutshmërisë së çështjes dhe gatishmërisë së avokatëve të listuar.

Mbetet ende për t'u zgjidhur kërkesa e vazhdueshme e Dhomës së Avokatisë Durrës për sigurimin e një ambienti të veçantë për avokatët, i cili pavarësisht vullnetit tonë pozitiv nuk është bërë ende i mundur të sigurohet për shkak të pamjaftueshmërisë së ambienteve të godinës.

Lidhur me marrëdhëniet me publikun, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës në mënyrë të veçantë i ka kushtuar rëndësi transparencës e cila ndihmon në përmbushjen e besueshmërisë për drejtësi, nëpërmjet bërjes publike dhe afishimit elektronikisht në hapësirën e pritjes së palëve ndërgjyqëse ku shpallen listat e gjykimeve, lista e çështjeve të hedhura në short, urdhrave të ndryshme të Këshillit të Gjykatës.

Mjaft efektive për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, ka rezultuar komunikimi me publikun nëpërmjet faqes elektronike zyrtare duke publikuar në faqen e saj elektronike zyrtare të gjithë informacionin dhe dokumentacionin e disponuar prej saj, të parashikuar nga ligji si të detyrueshëm për publikim.

Dokumentacioni i bërë publik, është i përditësuar në formë e përmbajtje. Faqja zyrtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës është ndërtuar në atë formë që mundëson informacion për publikun pa kërkesë në format lehtësisht të kuptueshëm.

Gjithashtu, i është kushtuar rëndësi aksesit të të interesuarve në dokumentacionin dhe aktet e gjendura në gjykate.

Për shkak të masave anti-Covid orari i shërbimit në sportel ka qenë i reduktuar, por me Vendimin Nr. 127 Prot., datë 05.07.2021, Këshilli i Gjykatës ka ndryshuar orarin e shërbimit në sportel duke krijuar orar të plotë shërbimi nga ora 08:00-16:00 për veprime të ndryshme me qytetarët dhe avokatët, duke vendosur njoftime me sqarime të nevojshme lidhur me çështje të caktuara, si dhe duke rritur në mënyrë të vazhdueshme efikasitetin dhe

etikën e personelit të gjykatës në komunikimin me qytetarët. Në mënyrë të veçantë përmendet këtu urdhërimi i kryesekretarisë dhe arkivës për të garantuar çdo informacion apo shërbim maksimalisht brenda 24 orëve.

Gjithashtu , për shkak të masave anti- Covid-19, për vitin 2021 gjykata nuk ka zhvilluar takime sensibilizuese me grupe të ndryshme si nxënës shkollash, studentë, qytetarë, etj., praktikë e cila është ndjekur çdo vit në kuadër të aktiviteteve në ditë të caktuara, si dhe në kuadër të afrimit sa më shumë të qytetarëve me gjykatën dhe sistemin e drejtësisë. Për vitin 2022 kjo praktikë e ndjekur do të vazhdojë nga ana e Gjykatës.

Por pavarësisht mos zhvillimit të këtyre aktiviteteve , Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës ka dhënë një ndihmesë dhe mundësi për të diplomuarit në drejtësi për një praktikë profesionale të tyre pranë kësaj gjykate.

Këshilli i Gjykatës miratoi hapjen e programit për mundësi praktike profesionale (internship) pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës për pozicion “Sekretar Gjyqësor” për një periudhë 4 muaj shtator – dhjetor 2021. Kjo erdhi si rezultat nisur nga eksperiencia e viteve të mëparshme por dhe për shkak të ngarkesës së madhe në punë e cila ka reflektuar në veprimtarinë e përditshme të administratës gjyqësore.

Në përfundim, duke vlerësuar se të dhënat e analizuara dhe problematikat e ngritura në këtë analizë pune për vitin 2021 do t'i shërbejnë si trupës gjyqësore, ashtu edhe institucioneve të tjera përkatëse që lidhen me sistemin gjyqësor, dëshiroj të shpreh në emrin tim dhe të trupës gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës angazhimin tonë maksimal për rritjen në vijimësi të performancës së kësaj Gjykate.

ZV. KRYETAR

PAULIN ÇERA

TABELA E NGARKESËS PËR GJYKATËN NË TËRËSI (Tabela 1)
CIVILE

ADMINISTRIMI I ÇËSHTJEVE											
Lloji i çështjes	Në pritje të gjykmimit në fillim të periudhës	Çështje të reja të paraqitura në gjykatë	Çështje të gjykuara						Në pritje të gjykmimit në fund të periudhës	Çështje të regjistruara gjithsej	
			Çështje të gjykuara gjithsej	Me vendim në themel		Me lloje të tjera disponimi					
				Nr.	%	Nr.	%				
1	2	3	4	5	6	7	8	9			
Çështje civile me palë kundërshtare (A.1+A.2+A.3+A.4)	1236	2489	2257	1451	64	806	36	1468	3725		
Civile të përgjithshme civile me palë kundërshtare	713	1827	1634	1262	77	372	23	906	2540		
Familiare me palë kundërshtare	510	603	601	179	30	422	70	512	1113		
Zgjidhje martesë	387	669	586	480	82	106	18	470	1056		
Tregtare me palë kundërshtare	10	2	4	2	50	2	50	8	12		
Marrëdhënie pune	3	57	18	8	44	10	56	42	60		
Çështje civile pa palë kundërshtare (B.1+B.2+B.3)	200	2882	2860	2611	91	249	9	222	3082		
Të përgjithshme civile pa palë kundërshtare	191	2805	2814	2574	91	240	9	182	2996		
Familiare pa palë kundërshtare	8	77	46	37	80	9	20	39	85		
Tregtare pa palë kundërshtare	1							1	1		
Faliment	2	2	3	1	33	2	67	1	4		
ÇËSHTJE CIVILE	1436	5371	5117	4662	79	1055	21	1690	6807		

TABELA E NGARKESËS PËR GJYKATËN NË TËRËSI (Tabela 1)
PENALE

ADMINISTRIMI I ÇËSHTJEVE														
Lloji i çështjes	Në pritje të gjykimin në fillim të periudhës	Çështje të reja të paraqitura në gjykatë	Çështje të gjykuara							Në pritje të gjykimin në fund të periudhës	Çështje të regjistruara gjithsej			
			Çështje të gjykuara gjithsej	Me vendim në themel				Me lloje të tjera disponimi						
				Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%					
Krime	229	869	909	874	96	35	4		8	9				
Vrasje me dashje (Neni 76.77,78,78/a,79, 79/a,79/b,79/c,81,82,83)	9	2	6	6	100	0	0		5	11				
Vjedhje (neni 139, 140, 141)	4	4	6	6	100	0	0		2	8				
Dhuna në familje	14	114	109	105	96	4	4		19	128				
Krime të kryera nga ose ndaj të miturve	2	33	33	29	88	4	12		2	35				
Kundërvajtje penale	90	120	142	113	80	29	20		68	210				
Kundërvajtje penale të kryera nga ose ndaj të miturve									0	0				
Çështje penale administrative	335	2306	2224	1944	87	280	13		417	2641				
Masa sigurimi		726	723	723	100		0		3	726				
Lirim me kusht	4	22	22	7	32	15	68		4	26				
Ekstradime	2	7	8	8	100		0		1	9				
Çështje të ligjit														
Antimafia	0	0	0	0		0			0	0				
ÇËSHTJE PENALE GJITHSEJ	654	3295	3275	2931	89	344	11		674	3949				

TABELLE KRAHASUESE PËR NGARKESËN E GJYKATËS NË TËRËSI (Tabela 2)

VITI	Numri i qeshjtëve për gjykim (themeli)		Qeshjtje të mbartura nga viti paraardhës		Qeshjtje të regjistruara në atë vit		Urdhëra Ekzekutimit	Qeshjtje të Përfunduara		Qeshjtje të mbaruara duke u zgjidhur jo në themel	Qeshjtje të mbartura për vitin në vijim		Kërkesa penale gjate fazës së hetimeve paraprake
	CIV.	PEN.	CIV.	PEN.	CIV.	PEN.		CIV.	PEN.		CIV.	PEN	
2014	2642	1332	610	241	2032	1091	1974	1993	1120	939	711	215	1293
Totali	3974		851		3123		1974	3113		939	926		1293
2015	3691	1547	711	215	2980	1332	1851	2113	1301	1079	776	281	1225
Totali	5238		926		4312		1851	3414		1079	1057		1225
2016	2789	1298	776	281	1986	1072	1977	2070	1111	837	804	258	1067
Totali	4087		1057		3058		1977	3181		837	1062		1067
2017	3150	1013	906	181	2224	832	1590	2631	820	1349	699	256	891
Totali	4163		1087		3076		1590	3451		1349	955		891
2018	3395	1129	699	256	2696	873	946	2522	852	1060	763	467	873
Totali	4524		955		3569		946	3374		1060	1230		873
2019	3372	1047	763	467	2629	848	1456	4074	3300	819	1076	50	806
Totali	4419		1230		3477		1456	7374		819	1582		

TABELË NGARKESËS INDIVIDUALE PËR ÇDO GJYOTAR (TABALA 3)

		PENALE		CIVILE		DELEGJIME		KËRKESA PENALE	KËRKESA CIVILE
		I VETËM	TRUP GJYKUES	I VETËM	TRUP GJYKUES	Penale	Civile		
EMRI/MBIEMRI	ÇESHTJE TE GJYKUARA								
Rexhep Bekteshi	880	176	1	107	0	0	0	317	279
Dhurata Bilo	110	0	0	47	4	0	0	0	59
Eda Kaja	731	159	1	78	1	0	0	316	176
Flora Hasimi	782	17	0	400	2	0	0	41	322
Markelian Koca	79	0	0	61	2	0	0	0	16
Shpetime Pitaku	987	36	0	431	4	0	0	122	397
Shpetim Reka	941	17	0	518	0	0	0	49	357
Vladimir Skenderi	907	138	1	84	0	0	0	395	289
Petraç Çuri	988	163	2	169	0	0	0	390	264
Besjana Garxenaj	826	165	0	98	0	0	0	286	277
Paulin Çera	806	170	0	84	1	0	0	304	247
Nurjeta Tafa	355	5	0	166	0	0	0	4	180
12	8392	1046	5	2243	14	0	0	2224	2863

Kërkesa të seancës paraprake
(TABALA 3/a)

Gjykatat e Rretheve Gjyqësore	Ç Ë S H T J E T			M Ě N Y R A E P Ě R F U N D I M I T							
	Çështje të mbartura	Të ardhura të reja	Gjithsej	Pranuar	Pushuar	Kaluar për gjykim	Kthim për plotësim hetimesh (penale)	Vendosur Moskompetenca	Të tjera	Përfunduar	Pa Përfunduar
Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës	298	1203	1501	858	61	0	23	1	11	954	547

ÇËSHTJET PENALE ME TË MITUR 2021

TABELA NR.3/b

Çështje penale me të pandehur të mitur Viti 2021		
Të regjistruara		Të përfunduara
33 çështje		33 çështje

Neni		MASA E DËNIMIT TE MITUR																						
TOTALI	0	Me gjobë	10	Deri në 2 vjet	1	2 (dy) - 5 (pesë) vjet	13	Aplikimi nenit 59	0	Kufizimi i lirisë	0	Aplikimi i nenit 59/a	5	Aplikimi i nenit 63	0	Përmbushja e detyrimeve të caktuara	0	Mjekim i detyruar (neni 46)	0	5(pesë)- 10 (dhjetë) vjet	0	10 (dhjetë) - 25 vjet	29	Gjithsej

Lloji i çështjes	ADMINISTRIMI I ÇËSHTJEVE									
	Në pritje të gjykimin në fillim të periudhës	Çështje të reja të paraqitura në gjykatë	Çështje të gjykuara						Në pritje të gjykimin në fund të periudhës	Çështje të regjistruara gjithsej
			Çështje të gjykuara gjithsej	Me vendim në themel		Me lloje të tjera disponimi				
				Nr.	%	Nr.	%			
Krime të kryera nga ose ndaj të miturve	2	33	33	29	88	4	12	2	35	

KËRKESA PËR HEQJE DORË VITI 2021

Tabela nr.3/c

Nr. Rendor	Emri i Gjyqtarit	Numri i kërkesave për heqje dorë		
		Miratuar	Refuzuar	Totali
1.	Paulin Çera	18		18
2.	Rexhep Bekteshi	10	8	18
3.	Eda Kaja	16		16
4.	Petra Çuri	19	2	21
5.	Nurjeta Tafa	3		3
6.	Shpëtim Reka	26	1	27
7.	Vladimir Skënderi	15	8	23
8.	Besjana Garxenaj	18		18
9.	Markelian Koça	0		0
10.	Flora Hasimi	24	3	27
11.	Shpëtime Pitaku	37	1	38
12.	Dhurata Bilo	2		2
	Totali:	188	23	211

TABELA E VENDIMEVE PËR DISA VEPRAT PENALE MË TË HASURA (TABELA 4)

Neni	MASA E DËNIMIT													Gjithsej
	Me gjobë	Deri në 2 vjet	2 (dy) - 5 (pesë) vjet	Aplikimi i nenit 58	Aplikimi i nenit 59	Aplikimi i nenit 59/a	Aplikimi i nenit 63	Aplikimi i nenit 64	Mjekimi i detyruar (neni 46)	5 (pesë) - 10 (dhjetë) vjet	10 (dhjetë) - 25 vjetë	25 (njzetepesë) - 35 (tridjetepesë) vjet	Burgim Përgjeshëm	
79/c	0	0	2	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1	3
88	0	5	3	0	0	0	0	0	0	3	0	0	0	11
108	0	2	0	0	1	0	0	0	0	1	0	0	0	4
130/a	0	42	1	5	54	0	2	0	1	0	0	0	0	105
134	6	62	0	0	9	0	0	0	0	0	0	0	0	77
135	2	0	0	0	4	0	4	0	0	0	0	0	0	10
143	0	6	0	0	7	0	0	0	0	0	0	0	0	13
145	0	0	0	0	8	0	0	0	0	0	0	0	0	8
178	0	0	0	0	5	0	2	0	0	0	0	0	0	7
181	11	3	0	0	3	0	0	0	0	0	0	0	0	17
186	0	3	0	0	6	0	2	0	0	0	0	0	0	11
199/a	2	8	0	0	35	0	10	0	0	0	0	0	0	55
236/2	2	14	0	0	6	0	2	0	0	0	0	0	0	24
248	0	2	0	0	11	0	3	0	0	0	0	0	0	16
278	3	2	3	0	7	0	0	0	0	0	0	0	0	15
283	0	2	11	0	14	0	0	0	0	4	0	0	0	31
290/2,3,4	0	5	3	0	13	0	5	0	0	0	0	0	0	26
291	63	32	2	0	163	0	21	0	0	0	0	0	0	281
298	0	4	0	0	3	0	0	0	0	0	0	0	0	7
Te Tjera	16	58	28	1	41	0	4	0	0	6	5	0	0	159
Shuma	109	250	53	6	394	0	57	0	1	14	5	0	1	890
ndërvajtje														
84	2	0	0	0	0	0	1	0	0	0	0	0	0	3
89	0	1	0	0	1	0	2	0	0	0	0	0	0	4
119	3	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	3
130/a1	0	2	0	0	3	0	2	0	0	0	0	0	0	7
137/1	0	0	0	0	11	0	0	0	0	0	0	0	0	11
159/1	2	0	0	0	2	0	0	0	0	0	0	0	0	4
179/a	3	0	0	0	0	0	1	0	0	0	0	0	0	4
197	2	0	0	0	3	0	1	0	0	0	0	0	0	6
242	8	4	0	0	1	0	2	0	0	0	0	0	0	15
273	2	3	0	0	1	0	1	0	0	0	0	0	0	7
297	6	8	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	14
Shuma Kv	28	21	0	0	22	0	10	0	0	0	0	0	0	81
TOTALI	137	271	53	6	416	0	67	0	1	14	5	0	1	971

TABELA E LLOJEVE DHE MASAVE TË DËNIMEVE (TABELA 5)

LLOJI I VENDIMIT TË DËNIMIT	NUMRI I RASTEVE
Dënime me burg	
Dënime deri në 2 vite burgim	316
2-5 vjet burgim	55
5-10 vjet burgim	26
10-25 vjet burgim	7
Burgim i përjetshëm	1
Dënime Alternative	
Burgim me kusht (Neni 59 i K.Penal)	457
Punë me interes publik (Neni 63 i K.Penal)	74
Vendime të tjera	
Dënim me gjobë	152
Pafajësi	32
Pushuar	41

Shënim: Në këtë tabelë përfshihen vetem llojet e dënimit për çështjet penale themeli.

TABELA E SHPEJTËSISË, BAZUAR NE KOHEZGJATJEN E GJYKIMIT
(TABELA NR.6)

	SHPEJTËSIA E GJYKIMIT (PENALE)			
	0 - 6 muaj	6 muaj - 1 vit	1 - 2 vjet	mbi 2 vjet
TOTALI	932	78	32	8

	SHPEJTËSIA E GJYKIMIT (CIVILE)			
	AFATI I PËRFUNDIMIT			
LLOJI I ÇËSHTJEVE	0 – 6 Muaj	6 muaj-1 vit	1 - 2 Vjet	Mbi 2 vjet
TOTALI	4172	586	304	53